



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

Nr. 12318 Prot

Shkodër, më 06 09.2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim relacion dhe projekt-vendim:

“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2023”.

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KRYETAR**

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

**“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME
QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR
PËR VITIN 2023”**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ .2023, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar; nenit 30 pika 2, të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” të ndryshuar; pika 11, 13 e VKM nr.522 datë 25.07.2019 “Metodika e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”, VKB nr.1 datë 22.01.2016 “Për taksat dhe tarifat vendore”, i ndryshuar; VKB nr.30 datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6 për vitin 2021”, VKB nr.31, datë 03.06.2021 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom”, VKB nr.23 datë.10.5.2022 “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare, e-mailin e datës 17.03.2023 të Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit”, Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër nr _____, datë _____.

VENDOSI:

1. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr. 6, për vitin 2023 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe 56.8 m²
 $3,316 + (3,316 \times 6.7\%) = 3,538$ Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe 88.9 m²
 $5,191 + (5,191 \times 6.7\%) = 5,539$ Lekë/Muaj).

Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe 96.1 m²
 $5,611 + (5,611 \times 6.7\%) = 5,987$ Lekë/Muaj).

2. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2023, si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m²

$$1,900 + (1,900 \times 6.7\%) = 2,027 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m²

$$2,500 + (2,500 \times 6.7\%) = 2,668 \text{ Lekë/Muaj.}$$

3. Të miratojë masën e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare për vitin 2023 si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m²

$$4,279 + (4,279 \times 6.7\%) = 4,566 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m²

$$4,729 + (4,729 \times 6.7\%) = 5,046 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m²


$$7,206 + (7,206 \times 6.7\%) = 7,689 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m²

$$8,107 + (8,107 \times 6.7\%) = 8,650 \text{ Lekë/Muaj.}$$

4. Të ardhurat e mbledhura nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin “Qira e ndërtesës” (nga banesat sociale me qira).
5. Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.
6. Niveli i qirasë i përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 është i vlefshëm deri me 31.01.2024.
7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Zv. Kryetar



KRYETAR

Benet Beci

Drejtoria e Shërbimeve Sociale,
Strehimit, Shëndetit Publik

Elvira Kacuri

Drejtoria e Financës

Blerta Ajdedy

Drejtoria Juridike

Marjola Fushkha

Drejtoria e të Ardhurave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE, STREHIMIT, SHËNDETIT PUBLIK

Nr. ____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2023

RELACION

“PËR MIRATIMIN E MASËS SË QIRASË MUJORE PËR BANESAT SOCIALE ME QIRA NË ADMINISTRIMIN E BASHKISË SHKODËR PËR VITIN 2023”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Në zbatim të pikës 11 të VKM nr.522 datë 25.07.2019, niveli i qirasë së miratuar në Këshill Bashkiak përdoret deri në fund të muajit janar të vitit pasardhës. Çdo vit, niveli i qirasë së miratuar nga Këshilli Bashkiak shumëzohet me indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak.

Sa më sipër, në zbatim të dispozitave ligjore, vlerat e qirasë për banesat sociale pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6, banesat sociale me qira për komunitetin rom si dhe për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare do të shumëzohen me indeksin e ndryshimit të çmimeve të konsumit, i cili, për vitin 2022 rezulton të jetë 6,7 %, sipas të dhënave periodike të publikuara nga INSTAT dhe e-mail i datës 17.03.2023 i Institutit të Statistikave INSTAT mbi “Ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të konsumit”,

1.Masa e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë Qendrës Komunitare “Për Familjen” nr.6 për vitin 2023, do të llogaritet si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A me sipërfaqe 56.8 m²
 $3,316 + (3,316 \times 6.7\%) = 3,538 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit B me sipërfaqe 88.9 m²
 $5,191 + (5,191 \times 6.7\%) = 5,539 \text{ Lekë/Muaj}$.

Qiraja mujore e apartamentit C me sipërfaqe 96.1 m²
 $5,611 + (5,611 \times 6.7\%) = 5,987 \text{ Lekë/Muaj}$

2.Masa e qirasë mujore për banesat sociale me qira për komunitetin rom për vitin 2023, do të llogaritet si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit 1+1 me sipërfaqe 30 m²

$$1,900 + (1,900 \times 6.7\%) = 2,027 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit 2+1 me sipërfaqe 40 m²

$$2,500 + (2,500 \times 6.7\%) = 2,668 \text{ Lekë/Muaj.}$$

3.Masa e qirasë mujore për banesat sociale me qira pranë ish-konviktit të shkollës Veterinare për vitin 2023 Bashkia Shkodër si më poshtë:

Qiraja mujore e apartamentit A 1+1 me sipërfaqe 33 m²

$$4,279 + (4,279 \times 6.7\%) = 4,566 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit B 1+1 me sipërfaqe 37 m²

$$4,729 + (4,729 \times 6.7\%) = 5,046 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit C 2+1 me sipërfaqe 55 m²

$$7,206 + (7,206 \times 6.7\%) = 7,689 \text{ Lekë/Muaj.}$$

Qiraja mujore e apartamentit D 2+1 me sipërfaqe 62 m²

$$8,107 + (8,107 \times 6.7\%) = 8,650 \text{ Lekë/Muaj.}$$

4.Të gjitha të ardhurat që mbliidhen nga qiratë e fondit publik të banesave sociale me qira të Bashkisë Shkodër do të derdhen në llogarinë ekonomike të Bashkisë Shkodër me kodin nr. 7109600 me emërtimin “Qira e ndërtesës” (nga banesat sociale).

5.Të ardhurat e depozituara nga qiratë e banesave sociale me qira përdoren nga strukturat përgjegjëse të administrimit të banesave sociale me qira për mirëmbajtjen dhe administrimin e tyre dhe raportohet mbi përdorimin e fondit si pjesë e programit buxhetor nr. Programi 10661, Strehimi Social.

Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit dhe Shëndetit Publik ka paraqitur pranë Këshillit Bashkiak projekt vendimin “Për miratimin e masës së qirasë mujore për banesat sociale me qira në administrimin e Bashkisë Shkodër për vitin 2023” me shkresën nr.4146 prot date 23.3.2023.

Në këto kushte, për realizimin e detyrimeve ligjore, kërkojmë nga ana juaj të miratoni “Masat e qirasë për Banesat Sociale për vitin 2023”, të llogaritura sipas VKM nr.522, datë 25.07.2019.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Shëndetit Publik

Gjini Kacerr

